

URDHËR
Nr. 7, datë 17.9.2025

PËR DELEGIMIN E PËRFAQËSIMIT LIGJOR
TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës, të neneve 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 7, pika 1, dhe 121 të Rregullores së Kuvendit,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese.
2. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.
3. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.
4. Modeli i autorizimit për përfaqësim në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.
5. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor/gjykim në Gjykatën Kushtetuese bëhet nga autoriteti i përcaktuar në pikën 1 dhe në pamundësi të tij, rast pas rasti, nga personat e përcaktuar me autorizim të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm.
6. Autoriteti i përcaktuar në pikën 1, personi që do të përfaqësojë Kuvendin, autorizohet për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile/penale/gjykimit në Gjykatën Kushtetuese.
7. Përfaqësimi i Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore/Gjykatën Kushtetuese, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në të gjitha nivelet përkatëse të gjykimit.
8. Urdhri nr. 52, datë 1.8.2024, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë” shfuqizohet.
9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Niko Peleshi

Nr. ____prot. (vendndodhja), më _____.____.2025

LIDHJA 1

AUTORIZIM

Për përfaqësimin në çështjen administrative/civile/penale dhe në Gjykatën Kushtetuese

Paditës/kërkues _____

I paditur/subjekt i interesuar _____

Objekt _____

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe urdhrit të Kryetarit të Kuvendit nr. ____, datë _____.____.2025, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë.

VENDOSA:

Autorizimin e z/znj. _____, me detyrë _____, për të përfaqësuar Kuvendin e Shqipërisë në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative, civile, penale, gjykim në Gjykatën Kushtetuese me objektin e sipërcituar deri në shpalljen e vendimit në gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve përkatëse/Gjykatën Kushtetuese.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM